




WESTERN BALKANS
ALLIANCE FOR
WORK-BASED
LEARNING

ERI | Education
SEE | Reform
Initiative of
South
Eastern
Europe

 Austrian
Development
Cooperation

METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E STANDARDEVE TË KUALIFIKIMEVE ME BAZË RAJONALE



Metodologjia për Zhvillimin e Standardeve të Kualifikimeve me Bazë Rajonale

Botues

Nisma e Evropës Juglindore për Reformën në Arsim
Deçanska 8, 11000 Beograd, Serbi
www.erisee.org office@erisee.org

Autorët

Ana Tecilazić
Marina Matešić

Për botuesin

Tina Šarić

Redaktues

Tina Šarić, Sekretariati i ERI SEE

Botuar

Beograd, qershor 2021

Përkthimi

Ermira Agolli
miragolli@hotmail.com

Projektimi

StudioTrid
<http://www.studiotrid.net>

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Hyrje | 6 |
| Metodologjia për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale | 8 |
| Hapi 1: Nisja e punës për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale | 10 |
| Hapi 2. Ngritja e grupeve rajonale të punës | 13 |
| Hapi 3. Dakordimi në lidhje me përshkruesit kryesorë të standardeve të kualifikimeve..... | 15 |
| Hapi 4. Zhvillimi i elementeve thelbësore të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale..... | 17 |
| Hapi pasues: Transpozimi i standardit rajonal të kualifikimit në standardin kombëtar të kualifikimit | 18 |
| Standardi i kualifikimit me bazë rajonale | 22 |

Hyrje

Metodologjia për Zhvillimin e Standardeve të Kualifikimeve me Bazë Rajonale (në vijim referuar si Metodologjia) është autorizuar në kuadër të projektit **Drejt standardeve të profesioneve me bazë rajonale**- TO REGOS¹. Projekti TO REGOS po zbatohet nga Nisma e Evropës Juglindore për Reformën në Arsim - Sekretariati i **ERI SEE**² dhe Aleanca e Ballkanit Perëndimor për Të Nxënit Nëpërmjet Punës³ në Shqipëri (SH), Bosnje dhe Hercegovinë (B&H), Kosovë (K)*⁴, Mali i Zi (MiZ), në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe Republikën e Serbisë (RS).

Kjo Metodologji vjen menjëherë pas gjetjeve të dala nga Studimi i Fizibilitetit për Zhvillimin e Standardeve të Kualifikimeve me Bazë Rajonale, mbi të cilat u bazua analiza krahasuese e kuadrit institucional dhe legjislativ në të gjashtë vendet, rekomandimet dhe kuadri i përgjithshëm metodologjik për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale.

Studimi i Fizibilitetit na provoi se ngjashmëritë në procesin e zhvillimit të standardeve kombëtare të kualifikimeve janë të shumta dhe se përfshirja në këtë eksperimentim politik ka një bazë të përbashkët.

Sidoqoftë, megjithëse në metodologjitë e tyre asnjëri nga vendet nuk e ka parashikuar në mënyrë të qartë mundësinë e zhvillimit të një standardi kombëtar të kualifikimit duke u bazuar në një standard rajonal të kualifikimit, kjo metodologji presupozon ekzistencën e një marrëveshjeje të përbashkët midis palëve kryesore të interesit në rajon për t'u angazhuar në një eksperimentim të tillë në nivelin e politikave.

Prandaj, është e rëndësishme që agjencitë përgjegjëse për AFP-në dhe/ ose kualifikimet në vendet në fjalë, të mbështetura nga ministritë e tyre të linjës, të jenë të hapura për tu përfshirë në një eksperimentim politik për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale dhe standardeve përkatëse të kualifikimeve kombëtare.

Është e rëndësishme që të sqarohet që në fillim që zhvillimi i standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale nuk synon të zëvendësojë metodologjitë dhe praktikatat ekzistuese të përdorura për zhvillimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve por të ofrojë një rrugë të mundshme për të gjitha vendet për të hartuar disa standarde kombëtare të kualifikimeve duke përdorur një bazë të përbashkët të përcaktuar në standardet e kualifikimeve me bazë rajonale.

Metodologjia e propozuar bazohet në kapacitetet e krijuara në të gjashtë vendet në drejtim të hartimit të politikave dhe praktikave përkatëse në fushën e zhvillimit dhe zbatimit të kornizave të kualifikimeve, dhe merr parasysh rrethanat specifike në secilin prej vendeve, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre institucionale për zhvillimin e elementeve që kanë të bëjnë me kornizat e kualifikimeve.

1 Projekti TO REGOS financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e siguruara nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Për më shumë informacion në lidhje me projektin mund të vizitoni Platformën WBA4WBL. <https://wba4wbl.com/about-to-regos-project/>

2 ERISSEE. <https://www.erisee.org/>.

3 WBA4WBL. <https://wba4wbl.com>

4 *Ky emërtim nuk paragjykon pozicionet në lidhje me statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.



Kuadri ligjor përbëhet nga sa vijon: Ligji për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (SH), Baza e Referimit për Kornizën e Kualifikimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë (B&H), Ligji për Kualifikimet Kombëtare (K)*, Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (MiZ), Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (RMV), Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në Republikën e Serbisë (RS).

Kuadri institucional përfshin sa vijon: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare për AFP-në dhe Kualifikimet, Komitetet Sektoriale (SH); Ministria e Çështjeve Civile, 12 autoritete arsimore, Agjencia për Arsimin Parashkollor, Fillor dhe të Mesëm (B&H); Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencia e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Të Rriturve, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (K)*; Ministria e Arsimit, Qendra e AFP-së, Këshilli për Kualifikimet, Komitetet Sektoriale (MiZ); Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra e AFP-së, Bordi për Kornizën e Kualifikimeve në Maqedoni, Komitetet Sektoriale (RMV); Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Ministria e Punës, Punësimin, Veteranëve dhe Politikave Sociale, Agjencia e Kualifikimeve, Këshilli për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Serbisë, Komitetet Sektoriale të Aftësive (RS).

Kuadri metodologjik merr parasysh sa vijon: Procesi i Zhvillimit të Standardeve të Kualifikimeve, Udhëzuesi Metodologjik për Hartimin e Përshkrimeve të Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri (SH); Standardet e Kualifikimeve në AFP në B&H (përmbledhje e metodologjisë) (B&H); Zhvillimi i Kualifikimeve Modulare, (K*); Metodologjia për Zhvillimin e Standardeve të Kualifikimeve, Metodologjia për Përfshirjen e Kualifikimeve në Kornizën Maqedonase të Kualifikimeve (RMV), Rregullorja për Procedurat e Zhvillimit të Kualifikimeve nga Niveli i Parë në Nivelin e Pestë të Kualifikimeve (MiZ); Rregullorja për Metodologjinë e Zhvillimit të Standardeve të Kualifikimeve (RS).

Metodologjia përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë paraqet procedurën për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale, duke përshkruar secilin prej hapave të procesit. Pjesa e dytë ofron disa direktiva metodologjike për zhvilluesit e kualifikimeve për strukturimin e përmbajtjes sipas modelit të dakorduar për standardet e kualifikimeve me bazë rajonale.

Dhe e fundit, është e rëndësishme të theksohet se kjo Metodologji mund të pësojë ndryshime me qëllim pasqyrimin e pengesave, zgjidhjeve dhe konkluzioneve të mundshme që dalin nga vetë procesi i zhvillimit të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale në praktikë.



Metodologjia për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale

Konkluzionet e dala nga analiza krahasuese e proceseve të zhvillimit të standardeve të kualifikimeve në të gjashtë vendet dhe identifikimi i praktikave të përbashkëta në të gjithë rajonin, të paraqitura në Studimin e Fizibilitetit, u pasua nga hartimi i një kornize të përgjithshme metodologjike e cila përfshin të gjitha proceset që ndodhin si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar në vendet në fjalë.

Kuadri i përgjithshëm metodologjik për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale fillon nga analiza e tregut të punës që rezulton në një standard profesioni me bazë rajonale.

Pas dakordimit midis partnerëve në lidhje me standardin e profesionit me bazë rajonale, fillon puna për zhvillimin e tij duke ndjekur një sërë hapash. Dy janë procedurat paralele që duhen ndjekur:

njëra procedurë ka të bëjë me miratimin e standardit kombëtar të profesionit që rrjedh pas modifikimit të një standardi rajonal të profesionit për ta përshtatur me specifikat kombëtare, nëse është e nevojshme, dhe procedura e dytë në lidhje me zhvillimin e standardit rajonal të kualifikimit ka të bëjë me përshkrimin e kualifikimit nëpërmjet përdorimit të një grupi të dakorduar me përshkrues të kualifikimit, me qëllim përgatitjen e standardit të kualifikimit me bazë rajonale. Hapi i fundit është përkthimi/ kthimi i standardit të kualifikimit me bazë rajonale në një standard kombëtar të kualifikimit.

Në këtë kontekst është e rëndësishme që të gjitha vendet të angazhohen për zhvillimin e një standardi rajonal të kualifikimit duke synuar përdorimin e tij si bazë për zhvillimin e standardit përkatës kombëtar të kualifikimit. Prandaj, për kualifikimet që nuk janë standardizuar ende në nivel kombëtar ose që kanë nevojë për modernizim në të gjitha vendet në fjalë, rekomandohet zhvillimi i standardeve me bazë rajonale. Sidoqoftë, kur kjo nuk është e mundur - kur në disa prej vendeve standardi kombëtar përkatës i kualifikimit është miratuar, kjo nuk duhet të përbëjë pengesë. Në një rast të tillë, pas dakordimit të një standardi rajonal të kualifikimit, ata marrin përsipër të rishikojnë standardin e tyre kombëtar të kualifikimit në masën e nevojshme dhe të përshtatshme me qëllim integrimin e perspektivës rajonale në standardin ekzistues të kualifikimit në nivel kombëtar.

Standardet e kualifikimeve me bazë rajonale nuk zëvendësojnë standardet kombëtare të kualifikimeve - ato janë elementet thelbësore të standardeve kombëtare të kualifikimeve dhe për këtë arsye shërbejnë si një bazë e përbashkët për zhvillimin e mëvonshëm të standardeve kombëtare të kualifikimeve.

Prandaj, standardet e kualifikimeve me bazë rajonale transpozohen në standardet kombëtare të kualifikimeve duke kryer rregullimet e nevojshme dhe duke plotësuar informacionin që mungon në varësi të kontekstit specifik të sistemit arsimor. Modifikimet për kalimin nga një standard rajonal kualifikimi në një standard kombëtar kualifikimi përfshijnë të gjitha tiparet specifike të standardeve kombëtare të kualifikimeve.

KËNDI I REFLEKTIMIT - JU LUTEM VINI RE QË ...

Kuadri metodologjik përfshin veprimet e ndërmarra në nivel rajonal dhe në nivel kombëtar në vendet në fjalë.

Metodologjia për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale në rajon përshkruan vetëm një pjesë të vogël të kuadrit të përgjithshëm metodologjik.



Procesi finalizohet me miratimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve që lindin nga standardet e kualifikimeve me bazë rajonale. Më pas për miratimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve zbatohen procedurat specifike të vendit të përfshirë në proces. Të gjithë procesin e gjeni të prezantuar në një vizatim të thjeshtuar në Diagramin 'Kudri metodologjik për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale'.

Diagrami 1: Kudri metodologjik për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale



Metodologjia përshkruan procedurën që përbëhet nga katër hapa si dhe hapin pasues në procesin e zhvillimit të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale.

Hapi 1: Nisja e punës për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale

Standardet e kualifikimeve me bazë rajonale zhvillohen duke u bazuar në standardet e profesioneve me bazë rajonale. Kjo do të thotë që vendimi në lidhje me kualifikimin që do të zhvillohet me qëllim hartimin e standardit të kualifikimit me bazë rajonale është marrë pjesërisht në momentin e zhvillimit të një standardi të profesionit me bazë rajonale.

Prandaj, vlen të përmendet se hapi i parë në procesin e zhvillimit të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale do të ishte identifikimi i profesioneve dhe kualifikimeve që mund të zhvillohen në nivel rajonal. Zgjedhja bëhet duke marrë parasysh rëndësinë e sektorëve, profesioneve dhe kualifikimeve të përzgjedhura në rajon si dhe duke u bazuar në diskutimet dhe konsultimet rajonale midis palëve përkatëse.

Treguesit e propozuar mbi të cilët mund të bazohet procesi për marrjen e vendimit në lidhje me kualifikimin që do të ishte i përshtatshëm për zhvillimin e standardit rajonal të kualifikimit janë si më poshtë:

- ◆ **Relevanca e përgjithshme dhe e gjerë për tregun e punës:** pas zhvillimeve të mëdha ekonomike, kompetencat e kërkuara në sektorë dhe profesione të caktuara ndryshojnë me shpejtësi duke nxjerrë në pah nevojën për të gjitha vendet për tu përshtatur me ndryshimet (p.sh. sektori i TI);
- ◆ **Potenciali për lëvizshmëri:** të dhënat për migracionin ndërkufitar dhe lëvizshmërinë në profesione specifike mund të përdoren për të vlerësuar potencialin e lëvizshmërisë;
- ◆ **Mungesat në tregun e punës:** të dhënat në lidhje me mungesat në tregun e punës (mangësitë) në nivel kombëtar mund të përdoren për të diskutuar nëse zhvillimi i standardit rajonal të kualifikimit mund të nxisë ndryshimet në programet dhe kualifikimet aktuale dhe të rrisë atraktivitetin e tyre.

Në disa prej vendeve, metodologjia për zhvillimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve fillon me marrjen e një aprovimi paraprak të nismës/ kërkesës për zhvillimin e standardit të kualifikimit nga autoriteti përkatës, zakonisht ministria përgjegjëse për arsimin ose komitetet sektoriale. Prandaj, është e këshillueshme që vendet në të cilat zbatohet një rregull i tillë të paraqesin tek autoriteti kombëtar përkatës nismën/ kërkesën për të zhvilluar standardin rajonal të kualifikimit të bazuar në standardin rajonal të profesionit.

Nisma/ kërkesa për zhvillimin e kualifikimit duhet të përmbajë arsyen përse nevojitet zhvillimi i një kualifikimi të ri duke zbatuar metodologjinë për zhvillimin e standardeve rajonale të kualifikimeve. Për më tepër, nisma/ kërkesa duhet të mbështetet më tej duke argumentuar kërkesën në tregun e punës dhe të përmbajë të gjithë elementët e tjerë siç përkrahjet në metodologjitë kombëtare (p.sh. 'titulli i kualifikimit, niveli, referenca në një kod që i referohet një profesioni të klasifikuar sipas *ISCO*, përshkrimi i përgjithshëm i kualifikimit dhe koha e nevojshme për zhvillimin e kualifikimit, etj.).

KËNDI I REFLEKTIMIT - JU LUTEM VINI RE QË ...

Procesi i zhvillimit të standardeve kombëtare të kualifikimit fillon me marrjen e miratimit paraprak nga autoriteti përkatës vetëm në disa prej vendeve. Për këto vende është e këshillueshme që të kërkohet miratimi para se të nisë puna për zhvillimin e standardit të kualifikimit me bazë rajonale.



Procesi fillon menjëherë pas marrjes së miratimit në të gjitha **ato vende ku kërkohet miratimi i nismës** si dhe vendimit në lidhje me standardin e kualifikimit që do të ishte me vlerë për tu zhvilluar në nivel rajonal.

Përputhja me kërkesat e tregut të punës

Synimi i të gjitha vendeve nën shqyrtim është hartimi i kualifikimeve të AFP-së duke u nisur nga vlerësimi i nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Prandaj, në të gjitha vendet, zhvillimi i standardeve të kualifikimeve është i përfshirë në analizën e tregut të punës. Dallimi midis tyre lidhet me faktin nëse në procedurat e tyre për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve të AFP, standardi i profesionit është përcaktuar si një hap i detyrueshëm apo jo.⁵ Në shumicën e rasteve, standardet kombëtare të profesioneve përmbajnë, ndër të tjera, informacion në lidhje me kompetencat e nevojshme për një profesion të caktuar.

Nga ana tjetër, standardet e profesioneve me bazë rajonale, siç parashikohet nga Metodologjia e përgatitur në kuadrin e projektit *TO REGOS* (Drejt standardeve të profesioneve me bazë rajonale), përmbajnë grupet e detyrave/ funksioneve, detyrat kryesore dhe aktivitetet, por jo kompetencat e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve. Aty ku kërkohet në nivel kombëtar, në procesin e përshtatjes së standardeve të profesioneve me bazë rajonale me specifikat kombëtare, kompetencat përcaktohen në bazë të detyrave dhe aktiviteteve kryesore. Kështu, standardet përkatëse të profesioneve në nivel kombëtar, aty ku ekzistojnë, mund të jenë një burim i vlefshëm i kompetencave të identifikuar për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve kryesore të paraqitura në standardin rajonal të profesionit.

Prandaj, si hap i parë, nevojitet mbledhja e të gjitha dokumenteve ekzistuese: një standard rajonal profesioni, standardet përkatëse kombëtare të profesionit nëse ekzistojnë dhe çdo burim tjetër i mundshëm informacioni në lidhje me kërkesën e tregut të punës.

Bazuar në të dhënat e mbledhura, *ERI SEE* përgatit bazën analitike për zhvillimin e një standardi rajonal të kualifikimit, me ndihmën e ekspertëve dhe në atë masë që do të bënte të mundur përgatitjen e terrenit nga ana e *ERI SEE* për diskutime në nivel rajonal.

Së pari, *ERI SEE* mund të nxjerrë nga standardet përkatëse të profesioneve me bazë rajonale informacionin në lidhje me detyrat kryesore, aktivitetet dhe kompetencat që nevojiten për kryerjen e aktiviteteve me qëllim lehtësimin e punës së mëtejshme për hartimin e standardit përkatës të kualifikimit me bazë rajonale.

Në parim, detyrat kryesore janë baza për zhvillimin e Njërive të Rezultateve të të Nxënës (NjRN) të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale, ndërsa rezultatet e të nxënës (RN) të standardeve të kualifikimit me bazë rajonale rrjedhin nga kompetencat (njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet) e renditura në bazën analitike.

Sidoqoftë, zhvillimi i NjRN-ve nga detyrat kryesore dhe i RN-ve nga aktivitetet/ kompetencat nuk është gjithmonë i vetëkuptueshëm dhe as një ushtrim i thjeshtë. Prandaj, për këtë qëllim nevojitet organizimi i diskutimeve në nivel rajonal dhe midis ekspertëve, duke u mbështetur në bazën analitike të përgatitur nga *ERI SEE*. Baza analitike duhet të organizohet duke ndjekur strukturën

⁵ Vendet që i kanë vendosur standardet e tyre të profesionit si një hap të detyrueshëm në procedurat e tyre për zhvillimin e një standardi kualifikimi në sektorin e AFP-së: Shqipëria, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia.



e standardit rajonal të profesionit (SRP), siç vijon në tabelën më poshtë. Aty paraqiten bazat për hartimin e RN-ve që do të korrespondojnë me kompetencat e renditura në bazën analitike. Pas hartimit, RN-të duhet të grupohen për të krijuar Njësitë e Rezultateve të të Nxënimit. Mund të ndodhë që kompetencat e kërkuara për një aktivitet në standardin rajonal të profesionit, kur transpozohen në rezultate të të nxënimit, duhet të rigrupohen në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që NJRN-të të përfaqësojnë një grup të RN-ve që i përkasin të njëjtit profil dhe që mund të vlerësohen bashkërisht.

1.1 Baza analitike për zhvillimin e një standardi kualifikimi me bazë rajonale

STANDARDI RAJONAL I PROFESIONIT: *Titulli i SRP-së*

STANDARDET KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (VENDET): *Titujt e SKP-ve përkatëse, nëse ekzistojnë, në gjuhën angleze dhe në gjuhën origjinale dhe vendet të cilave i përkasin.*

| GRUPI I DETYRAVE / FUNKSIONEVE, DETYRAT DHE AKTIVITETET KRYESORE | KOMPETENCAT e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve kryesore | REZULTATET E TË NXËNIT | NJËSITË E REZULTATEVE TË TË NXËNIT |
|--|--|---|--|
| Shkruani grupin e parë të detyrave nga SRP 1. Grupi i detyrave | | | |
| Renditni këtu detyrën e parë kryesore që i përket grupit të parë të detyrave 1.1 Detyra kryesore... | | | 1.1. NJRN... |
| Renditni këtu aktivitetet që i përkasin detyrës së parë kryesore. 1.1.1. Aktiviteti... 1.1.2. Aktiviteti ... 1.1.3. ... | Renditni këtu kompetencat (njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet) e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve. 1.1.1. Aftësia ... 1.1.2. Njohuria... 1.1.3. Qëndrimi... | Renditni këtu rezultatet e të nxënimit që rrjedhin nga kompetencat. 1.1.1. RN... 1.1.2. RN ... 1.1.3. RN | Gruponi këtu RN-të në njësi. Vini re se një Njësi e rezultateve të të nxënimit mund të përmbajë RN, të cilat rrjedhin nga aktivitete të ndryshme. p.sh.: 1.1.1.RN... 2.1.4 RN... |

Hapi 2. Ngritja e grupeve rajonale të punës

Hapi i dytë është ngritja e grupeve rajonale të punës për secilin standard të kualifikimit me bazë rajonale. Grupi rajonal i punës është një grup i krijuar nga **ERI SEE** dhe që përbëhet nga anëtarë të mandatuar nga autoritetet në të gjashtë vendet e përfshira për të zhvilluar një standard kualifikimi me bazë rajonale.

Grupi nuk duhet të jetë shumë i madh në mënyrë që të jetë sa më funksional. Numri i anëtarëve të grupit të punës nuk duhet të jetë me shumë se katërbëdhjetë, dy nga secili vend, një moderator/ ekspert dhe një përfaqësues i **ERI SEE** si koordinator. Përbërja e propozuar është si më poshtë:

- ◆ Përfaqësues të agjencive ose ekspertë të standardeve të profesioneve/ kualifikimeve;
- ◆ Ekspertë me njohuri dhe aftësi specifike sektoriale.

Rekomandohet që grupi të përbëhet nga përfaqësues të agjencive përgjegjëse për kualifikimet e AFP-së në të gjashtë vendet dhe ekspertë që kanë njohuri dhe aftësi specifike sektoriale të cilët janë mësues të trajnuar që njohin koncepte të tilla si rezultatet e të nxënit dhe korniza e kualifikimeve.

Në të gjitha vendet e përfshira, agjencitë përgjegjëse për kualifikimet e AFP-së janë ata që marrin përsipër zhvillimin e një standardi kualifikimi ose e miratojnë atë. Prandaj, këto agjenci janë aktorët më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale.

Profili i ekspertëve sektorialë duhet të përputhet sa më shumë që të jetë e mundur me profilin e standardit rajonal të kualifikimit që është duke u zhvilluar.

Puna e grupeve të punës mund të lehtësohet nga ekspertë që njohin metodologjitë e zhvillimit të standardeve të kualifikimeve në përgjithësi.

Meqenëse në disa prej vendeve, përbërja specifike e grupeve të punës që zhvillojnë standardet kombëtare të kualifikimeve përkrahë në metodologjitë përkatëse, këtu mund të ngrihet pyetja nëse kjo përbërje duhet të zbatohet edhe për grupet e punës që merren me zhvillimin e standardeve rajonale të kualifikimeve. Për shembull, në disa metodologji për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve është e rëndësishme që anëtarët e grupit të kenë përvojë pune në fushën përkatëse të profesionit dhe të jenë përfaqësues të sektorit të biznesit, dhe arsimit dhe formimit profesional.

Rekomandohet që kërkesa të tilla të mos zbatohen për grupet e punës të angazhuara me zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale, sepse një grup i tillë pune mund të jetë shumë i madh në numër dhe si i tillë, jo funksional, do të kërkonte burime të konsiderueshme njerëzore dhe mund të ishte i paekuilibruar për nga numri i personave që vijnë nga vende të ndryshme.

Sidoqoftë, në respektim të kërkesave të mundshme kombëtare, këshillohet krijimi i një grupi të tillë pune në nivel kombëtar dhe përdorimi i tij si organ konsultativ në procesin e zhvillimit të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale.

KËNDI I REFLEKTIMIT - JU LUTEM VINI RE QË ...

*Përbërja specifike e grupeve të punës që duhen ngritur për zhvillimin e standardeve **kombëtare** të kualifikimit nuk është e nevojshme të zbatohet për grupin **rajonal** të punës sepse grupet kombëtare të punës do të diskutojnë, gjithsesi, edhe transpozimin e standardeve të kualifikimit me bazë rajonale në standarde kombëtare të kualifikimit.*

Një ose dy anëtarë të këtij grupi mund të emërohen si ekspertë në grupin rajonal të punës dhe të luajnë rolin e ndërmjetësuesit për të lehtësuar komunikimin midis grupit kombëtar të punës dhe grupit rajonal të punës. Roli i grupit kombëtar të punës është të japë kontributin e tij në grupin rajonal të punës, të japë mendime në lidhje me versionet paraprake të standardeve rajonale të kualifikimeve dhe pas dakordimit të këtyre të fundit t'i përdorë ato si bazë për zhvillimin e standardit përkatës të kualifikimit në nivel kombëtar.

Është e rëndësishme që anëtarët e grupit të punës të punojnë së bashku drejt të njëjtit objektiv, që do të thotë të arrijnë konsensusin në lidhje me standardin e kualifikimit me bazë rajonale. Arritja e konsensusit dhe dakordësisë midis të gjithë anëtarëve qëndron në themel të përpjekjeve të pritshme për transpozimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale në standardet kombëtare të kualifikimeve. Prandaj, në këtë proces duhet të shmanget modaliteti i votimit, dhe të arrihet një marrëveshje e qartë në lidhje me parimin e konsensusit si modalitet i vendimmarrjes.

Megjithëse gjuha e punës e grupit preferohet të jetë gjuha angleze, *ERI SEE* është përgjegjëse për të organizuar përkthimin me shkrim dhe me gojë sipas kërkesës dhe bazuar në nevojat e një grupi të caktuar.

Puna e grupit rajonal të punës ka nevojë për mbështetje të fortë operacionale. Prandaj *ERI SEE* merr përsipër të koordinojë bashkëpunimin, të përgatisë materialet e punës si dhe të sigurojë mbështetje operacionale për grupet e punës.

KËNDI I REFLEKTIMIT - JU LUTEM VINI RE QË ...

Duhet shmangur çdo konflikt interesi. Ata ekspertë që marrin pjesë në zhvillimin e standardeve të kualifikimeve nuk duhet të përfshihen në vlerësimin dhe gjykimin e tyre.

Në shumicën e vendeve, pranë agjencive përgjegjëse për AFP-në dhe/ose të gjitha kualifikimet janë krijuar organe të ndryshme që zakonisht janë pjesë e tyre dhe që, në parim, janë përgjegjëse për vlerësimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve. Anëtarët e këtyre organeve janë zakonisht ekspertë të sektorit,

por puna e tyre nuk është e lidhur posaçërisht dhe as me kohë të plotë me zhvillimin e kualifikimeve dhe për këtë arsye, ata janë jo domosdoshmërisht persona me përvojë apo të informuar në mënyrë të drejtpërdrejt në lidhje me nismat më të fundit si ajo për kornizat e kualifikimeve me bazë rajonale. Prandaj këshillohet që këto organe të informohen me kohë për procesin dhe të garantohet mbështetja e tyre e plotë në eksperimentimin me politikat për standardet e kualifikimeve me bazë rajonale.

Sidoqoftë, vlen të përmendet që anëtarët e organeve të tilla nuk duhet të përfshihen drejtpërdrejt në zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale (as në zhvillimin e standardeve kombëtare të kualifikimeve) sepse është e rëndësishme që të respektohet parimi i vlerësimit të pavarur dhe të paanshëm që në momentin e transpozimit të standardit rajonal të kualifikimit në një standard kombëtar dhe propozimit të tij për miratim/ përfshirje në kornizat kombëtare të kualifikimeve.



Hapi 3. Dakordimi në lidhje me përshkruesit kryesorë të standardeve të kualifikimeve

Përshkruesit kryesorë të çdo kualifikimi janë profili/ lloji, niveli, vëllimi/ ngarkesa e punës dhe cilësia. Para zhvillimit të një standardi kualifikimi, grupi rajonal i punës duhet të arrijë një marrëveshje në lidhje me katër përshkruesit kryesorë të kualifikimit të përgjithshëm që duhet të përputhen me standardin përkatës të profesionit (d.m.th. profilin / llojin, nivelin, vëllimin / ngarkesën e punës, cilësinë).

KËNDI I REFLEKTIMIT - JU LUTEM VINI RE QË ...

Kualifikimet përshkruhen në termat e:

profilin / llojit - sektorit

nivelin - KKK dhe KEK

vëllimit / ngarkesës së punës - kredite në pikë ose orë

cilësisë – kërkesat për akreditimin

Profili dhe lloji i kualifikimit nënkupton përkatësinë e tij në një sektor të caktuar. Është e rëndësishme që grupi i punës të pajtohet me klasifikimin sektorial të këtij kualifikimi.

Agjencitë përgjegjëse për AFP-në dhe/ose kualifikimet në vendet në fjalë duhet të diskutojnë dhe të bien dakord për klasifikimin e kualifikimeve sipas sektorëve të

AFP-së para se të fillojnë punën për zhvillimin e një standardi kualifikimi. Në këtë rast këshillohet përdorimi i klasifikimit *EUROSTAT ISCED-F* (Fushat e Arsimit dhe Formimit). Dakordimi në lidhje me klasifikimin sektorial të një kualifikimi është i rëndësishëm pasi zgjedhja e sektorit do të orientojë më pas edhe punën për zhvillimin e rezultateve specifike të të nxëniet për sektorin.

Klasifikimi i kualifikimeve sipas sektorëve të AFP-së mund të jetë sfidues dhe kjo lidhet me përdorimin e metodologjive të ndryshme nga vendet e ndryshme për klasifikimin e kualifikimeve sipas fushave të arsimit dhe formimit. Kjo mund të jetë edhe më sfiduese në ato vende ku është krijuar një strukturë institucionale më komplekse për të mbështetur zhvillimin dhe miratimin e standardeve të kualifikimeve, e cila përfshin organe sektoriale si për shembull komitetet sektoriale ose komitetet sektoriale të aftësive që janë përgjegjës për vlerësimin e standardeve të propozuara të kualifikimeve.

Më konkretisht, nëse propozimet për standardet e kualifikimeve me bazë rajonale pranohen si standarde që i përkasin sektorëve të ndryshëm në vendet e përfshira në proces, atëherë kjo mund t'i hapë rrugën prirjes për ta vënë theksin më shumë tek njësitë e rezultateve të të nxëniet që u përkasin sektorëve të ndryshëm të cilat, për pasojë, mund të vënë në rrezik qëllimin e të gjithë përpjekjes për arritjen e dakordimit në nivel rajonal.

Para nisjes së punës për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve sugjerohet të arrihet dakordimi në lidhje me klasifikimin e një kualifikimi në një sektor të caktuar, dhe, nëse është e mundur kjo duhet të bëhet që në fazën e zhvillimit të standardit rajonal të profesionit, sepse klasifikimi sektorial mund të jetë i rëndësishëm për disa vende kur bëhet fjalë për procesin e prezantimit të iniciativës dhe marrjes së miratimit paraprak për zhvillimin e një standardi kualifikimi mundësisht nga një organ sektorial në nivel kombëtar. Prandaj njohja e përkatësisë së një kualifikimi në një sektor dhe rrjedhimisht marrja e vendimit në lidhje me komitetin sektorial nga i cili do të merret aprovimi paraprak janë shumë të rëndësishme.

Niveli i kualifikimit varet nga niveli i përshkruesve të rezultateve të të nxëniet. Grupi i punës duhet të arrijë dakordësinë në lidhje me nivelin e standardit rajonal të kualifikimit në KEK, i cili përshkruhet nga përshkruesit e rezultateve të të nxëniet për nivelin përkatës.⁶

6 Rekomandimi i Këshillit i datës 22 maj 2017 për Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të nxëniet gjatë



Standardi i kualifikimit me bazë rajonale i referohet vetëm Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe jo niveleve të kualifikimeve kombëtare. Meqenëse pothuajse të gjitha vendet kanë paraqitur raportet e tyre në lidhje me referimin e kornizës së tyre të kualifikimeve përkundrejt Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, ato tashmë kanë krijuar një referencë midis niveleve të kualifikimeve kombëtare me nivelet e KEK.

Niveli i kualifikimit në kornizën kombëtare të kualifikimeve duhet të caktohet në një fazë të mëvonshme, gjatë procesit të miratimit të standardit kombëtar të kualifikimit, sepse verifikimi i tij mund të ndodhë vetëm nëse propozimi për një standard kualifikimi vlerësohet pozitivisht, miratohet dhe përfshihet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Vëllimi i kualifikimit, i përshkruar në termat e *ECVET* (Sistemi Evropian i Krediteve për Arsimin dhe Formimin Profesional) duhet të dakordohet para se të nisë puna për zhvillimin e standardit përkatës të kualifikimit. Këshillohet që standardi i kualifikimit të përgatitet vetëm për pjesën profesionale të kualifikimit duke e lënë mundësinë për përcaktimin e komponentëve të arsimit të përgjithshëm të kualifikimit në nivel programi. Sidoqoftë, nevojitet arritja e dakordimit në lidhje me pjesën që duhet të zënë komponentët e arsimit të përgjithshëm brenda një kualifikimi si një element i standardit të kualifikimit.

Cilësia e kualifikimit përshkruhet me kërkesat specifike për akreditimin të cilat japin informacion në lidhje me sistemin e sigurimit të cilësisë që mbështet përfshirjen e kualifikimeve në kornizën e kualifikimeve. Meqenëse standardet e kualifikimeve me bazë rajonale nuk i nënshtrohen ndonjë procedure specifike akreditimi dhe as nuk supozohet që të përfshihen në ndonjë regjistër kombëtar si të tilla, nocioni i cilësisë duhet të mbahet parasysh vetëm gjatë hapave që do të pasojnë zhvillimin e standardeve rajonale të kualifikimeve.

gjithë jetës dhe shfuqizimi i rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2008 për krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës



Hapi 4. Zhvillimi i elementeve thelbësore të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale

Të gjitha vendet kanë identifikuar disa elemente të detyrueshme të cilat duhet të jenë pjesë e formateve model që përdoren për standardet e kualifikimeve në nivel kombëtar. Megjithëse nganjëherë të emërtuara ndryshe, ata përdorin koncepte pak a shumë të ngjashme për të përshkruar kualifikimet. Analiza krahasuese e elementeve të standardeve kombëtare të kualifikimeve, e paraqitur në Studimin e Fizibilitetit, është përdorur si bazë për identifikimin dhe propozimin e elementëve thelbësorë minimalë që duhet të përfshihen në standardet e kualifikimeve me bazë rajonale. Grupi rajonal i punës zhvillon një standard kualifikimi me bazë rajonale duke përdorur formatin model me elementet e një standardi kualifikimi të përfshirë në këtë Metodologji.

Për ta realizuar këtë, grupet rajonale të punës besojnë fort në mbështetjen operacionale të *ERI SEE*. Mbështetja operacionale nënkupton që *ERI SEE* merr përsipër të koordinojë punën për emërimin dhe ecurinë e grupeve rajonale të punës që nga fillimi deri në dakordimin përfundimtar të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale. Në veçanti, *ERI SEE* kryen detyrat e mëposhtme:

- ◆ Organizimi i **takimeve koordinuese** me autoritetet kombëtare për të rënë dakord në lidhje me hapat konkretë që duhen ndërmarrë për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale, si dhe afatin kohor dhe burimet e nevojshme.
- ◆ Koordinimi i punës për **emërimin** e anëtarëve të grupit rajonal të punës si përfaqësues të autoriteteve të gjashtë vendeve. *ERI SEE* konsultohet me secilin prej vendeve sa i takon mënyrës së zgjedhjes së ekspertëve më të përshtatshëm duke ndjekur parimet e paraqitura në këtë Metodologji.
- ◆ Koordinimi i **punës** së grupeve rajonale të punës që përfshin caktimin e takimeve (në distancë/ në internet ose ballë për ballë), sigurimin e ambienteve të punës, mbulimin e kostove të takimeve ballë për ballë, dërgimin e ftesave që marrin parasysh mundësinë për pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve.
- ◆ Përgatitja e **materialeve të punës** për të mbështetur diskutimin në grupin rajonal të punës që përfshin kryerjen e hulumtimeve paraprake, përgatitjen e sfondit analitik, të dhënave dhe provave që mund të përdoren për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale. Për ta realizuar këtë, *ERI SEE* mund të autorizojë përgatitjen e studimeve ose kryerjen e një studimi më kompleks që konsiderohet si i nevojshëm për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale.
- ◆ Përgatitja e **versioneve paraprake dhe të rishikuara** të standardeve rajonale të kualifikimeve të propozuara nga ekspertët si anëtarë të grupeve rajonale të punës, mbledhja e komenteve, përgatitja e pyetjeve për diskutim, rishikimi i versioneve paraprake pas diskutimit dhe i komenteve me shkrim të paraqitura nga anëtarët deri në hartimin e versionit përfundimtar.
- ◆ Sigurimi i **mbështetjes gjuhësore** që ka të bëjë me përgatitjen e përkthimeve dhe sigurimin e përkthimit me gojë kur dhe ku është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe anëtarët e grupeve rajonale të punës.
- ◆ **Moderimi i diskutimeve** dhe dhënia e ndihmesës me qëllim arritjen e konsensusit për standardet e kualifikimeve me bazë rajonale. Për ta realizuar këtë, *ERI SEE* mund të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm për të lehtësuar diskutimet.

Hapi që ka të bëjë me zhvillimin e elementeve thelbësorë të standardeve të kualifikimeve me bazë rajonale paraqitet dhe shtjellohet më hollësisht në pjesën e dytë të Metodologjisë.



Hapi pasues: Transpozimi i standardit rajonal të kualifikimeve në standardin kombëtar të kualifikimeve

Në mënyrë që standardet e kualifikimeve me bazë rajonale të arrijnë të përdoren, ata duhet të transpozohen në regjistrat e kornizave të kualifikimeve të secilit prej vendeve. Pas dakordimit midis vendeve, standardi i propozuar i kualifikimeve duhet të merret nga grupet kombëtare të punës si bazë për zhvillimin e standardit kombëtar të kualifikimeve. Standardet e kualifikimeve me bazë rajonale duhet të përshtaten me kërkesat kombëtare pa ndryshuar elementët thelbësorë të dakorduar të standardit rajonal të kualifikimeve dhe më pas të paraqiten për miratim duke ndjekur procedurat e përcaktuara në nivel kombëtar. Në këtë proces është e rëndësishme të pranohet fakti që ky është një standard kualifikimi i dakorduar në nivel rajonal. Prandaj, vendet e tjera duhet të njoftohen nëse gjatë procesit të miratimit do të kërkohej kryerja e ndonjë ndryshimi në elementet thelbësore, duke e bërë kështu të nevojshëm rishikimin e mundshëm të standardit rajonal të kualifikimit.

Dhe e fundit, së bashku me standardin e miratuar të kualifikimit duhet të publikohet edhe informacioni në lidhje me elementet plotësuese si edhe elementet dalluese, shoqëruar me rekomandimin për marrjen në konsideratë të këtij informacioni gjatë procedurave të njohjes. Në planin afatgjatë, nëse pilotohet me sukses, ky mund të shërbejë si një model për njohjen automatike të kualifikimeve që janë plotësisht në përputhje me standardet e kualifikimeve me bazë rajonale. Kjo, natyrisht, duhet të mbështetet dhe parashikohet edhe në legjislacionin që rregullon njohjen e kualifikimeve.

Standardi i kualifikimit me bazë rajonale

Modeli për standardin rajonal të kualifikimit përmban udhëzime në lidhje me mënyrën e plotësimit të formatit model dhe të përshkrimit të secilit prej elementeve të një standardi rajonal të kualifikimit. Fshijini udhëzimet gjatë plotësimit të modelit me informacion.

| Standardi i kualifikimit | |
|---|--|
| Titulli i kualifikimit | Përkruani titullin e kualifikimit në gjuhën angleze dhe në të gjitha gjuhët zyrtare të vendeve në Ballkanin Perëndimor. (p.sh. standardi i kualifikimit me bazë rajonale për teknik/e për ho-tele-restorante) |
| Lloji i kualifikimit | Shpjegoni nëse ky standard i përket një kualifikimi në arsimin e përgjithshëm, arsimin dhe formimin profesional ose arsimin e lartë, nëse ky kualifikim mund të përftohet edhe në arsimin dhe formimin e të rriturve dhe nëse ky kualifikim duhet të jetë i përshtatshëm për t'u akorduar në sistemin e validimit të të nxënimit informal dhe joformal. |
| Përshkrimi / arsyeja / baza logjike/nevoja për kualifikimin | Përkruani arsyen përse ky kualifikim është i nevojshëm dhe në veçanti jepni informacion për të provuar kërkesën në tregun e punës për këtë kualifikim. Përkruani qëllimet e kualifikimit dhe grupet kryesore të synuara të nxënësve. Specifikoni arsyen përse ky kualifikim është i rëndësishëm në nivel rajonal. Renditni çdo aprovim paraprak të marrë nga autoritetet kombëtare (nëse ka). |
| Standardet përkatëse të profesioneve, lidhja me klasifikimin ISCO ose ndonjë provë tjetër në lidhje me konsultimin me palët e interesit të tregut të punës | Referojuni metodologjive të përdorura për hulumtimin dhe analizimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës dhe, në veçanti, standardit të profesionit me bazë rajonale të përdorur si bazë për zhvillimin e këtij standardi rajonal të kualifikimit. Sugjeroni klasifikimet përkatëse në klasifikimet kombëtare të profesioneve në vendet në rajon, nëse ka. |
| Niveli i kualifikimit (KEK) | Përcaktoni nivelin në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për Të Nxënimit Gjatë Gjithë Jetës (KEK 1-8). Përcaktimi i nivelit të KEK nënkupton nivelin në kornizën përkatëse kombëtare të kualifikimeve bazuar në raportet e referimit të kornizave kombëtare të kualifikimeve në KEK. |

Vlera e krediteve të kualifikimit ose kohëzgjatja në vite / orë dhe pjesa e njësive të arsimit të përgjithshëm në kualifikimin e përgjithshëm

Përkruani vëllimin e kualifikimit në termat e ECVET. ECVET këtu përdoret për të përshkruar ngarkesën e punës, d.m.th. orët e nevojshme për një individ për të arritur rezultatet e të nxënës të këtij kualifikimi. Ai përfshin si periudhën e induktimit, ashtu edhe periudhën kohore të shpenzuar në aktivitete mësimore dhe formuese jashtë klasës. Në mungesë të një formule të dakorduar bashkarisht, shpjegoni numrin e orëve mësimore të përcaktuara për një kredit ECVET.

Kreditet ECVET caktohen vetëm për pjesën profesionale të standardit të kualifikimit. Sidoqoftë, ju duhet të përcaktoni pjesën e komponentëve profesionalë brenda një kualifikimi si një element i standardit të kualifikimit (p.sh. 60% e vëllimit të përgjithshëm të kualifikimit duhet të jenë njësitë e rezultateve të të nxënës në AFP dhe 40% e vëllimit të përgjithshëm të kualifikimit do të jenë njësitë e rezultateve të të nxënës në arsimin e përgjithshëm).

Spektori / fusha e punës (sipas klasifikimit ISCED)

Përkruani klasifikimin e kualifikimit sipas EUROSTAT ISCED-F (Fushat e Arsimit dhe Formimit).

Shënoni sektorin/ sektorët e përbashkët për këtë kualifikim në të gjashtë vendet.

Shpjegoni këtu çdo ndryshim të rëndësishëm dhe të konsiderueshëm sa i takon klasifikimit të kualifikimit në vendet përkatëse.

Kërkesat specifike për sigurimin e cilësisë në lidhje me kualifikimin

Të gjitha vendet duhet të përdorin këtu informacionin në lidhje me organin vlerësues që licencën institucionet arsimore, bën akreditimin, verifikimin ose jep miratimin për institucionet arsimore për të ofruar programe që çojnë në akordimin e një kualifikimi të caktuar. Kjo është e gjitha pjesë e sistemeve të ndryshme të sigurimit të cilësisë në të gjashtë vendet.

Gjatë hartimit të standardit të kualifikimit me bazë rajonale, është e rëndësishme që të njoftohen të gjitha palët e përfshira në lidhje me ndonjë kërkesë specifike për akordimin e këtij kualifikimi që duhet të respektohet në procedurat e sigurimit të cilësisë që do të pasojnë në nivel kombëtar (për shembull: Kualifikimi 'Infermier/e' duhet të akordohet vetëm pas përfundimit të një programi të akredituar si AFP formale, fillestare).

Përkruani kërkesat specifike në lidhje me këtë kualifikim, të cilat konsiderohen si të rëndësishme për të gjitha vendet kur bëhet fjalë për modalitetet e sigurimit të cilësisë.

| | |
|--|---|
| <p>Kërkesat për pranimin/hyrjen/ parakushtet për përfitim e kualifikimit</p> | <p>Përshkruani kërkesat për pranimin në këtë kualifikim në aspektin e kualifikimit paraprak që duhet të përftohet (p.sh. shkolla fillore ose kualifikimi i nivelit 1 të KEK) si dhe çdo kërkesë tjetër specifike të mundshme, si për shembull provimi i pranimit.</p> |
| <p>Progresi / përshkueshmëria në sistemin e kualifikimit/ kualifikimi i mëtejshëm dhe mundësitë e punësimit</p> | <p>Përshkruani shtigjet e mundshme dhe të mëtejshme profesionale duke shpjeguar nëse ky kualifikim hap rrugën drejt arsimit të lartë dhe/ ose tregut të punës.</p> |
| <p>Struktura e kualifikimit: Lista e njësive të detyrueshme të rezultateve të të nxënit dhe njësive me zgjedhje të rezultateve të të nxënit</p> | <p>Renditni njësitë e detyrueshme të rezultateve të të nxënit dhe mundësisht edhe njësitë me zgjedhje të rezultateve të të nxënit. Kjo pjesë duhet të plotësohet e fundit. Pas arritjes së marrëveshjes për rezultatet thelbësore të të nxënit, të shprehura në njohuri, aftësi dhe kompetenca, njësitë e rezultateve të të nxënit renditen këtu të përmbledhura.</p> |
| <p>Dakordimi për standardin e kualifikimit me bazë rajonale</p> | <p>Për të garantuar transparencën, përshkruani shkurtimisht procesin që çoi në arritjen e dakordimit të standardit rajonal të kualifikimit si bazë për zhvillimin dhe miratimin e standardit përkatës të kualifikimit kombëtar (përbërja e grupit të punës, data).</p> |

Njësitë e rezultateve të të nxënit

Njësitë e rezultateve të të nxënit janë rezultatet thelbësore të të nxënit, të shprehura në njohuri, aftësi dhe kompetenca dhe të strukturuar në njësi që përbëhen nga niveli, ngarkesa e punës dhe profili specifik. Rezultatet e të nxënit të strukturuar në një njësi duhet të vlerësohen lehtësisht me anën e një metode të përshtatshme vlerësimi si dhe me notë në varësi të kritereve specifike të përcaktuara në programet mësimore ose institucionet arsimore ofruese të programit. Në këtë pjesë të fundit, secila prej njësive të rezultateve të të nxënit duhet të përshkruhet nga një grup rezultatesh thelbësore të të nxënit, të përcaktuara si njohuri, aftësi dhe qëndrime.

Kjo tabelë duhet të plotësohet me mbështetjen e bazës analitike të përdorur për nxjerrjen e rezultateve të të nxënit nga aktivitetet e renditura në një standard profesioni me bazë rajonale, të cilat grupohen në njësi të rezultateve të të nxënit që korrespondojnë me detyrat kryesore në standardin përkatës rajonal të profesionit. Sidoqoftë, ekspertët duhet të jenë të kujdesshëm gjatë përkthimit të aktiviteteve dhe kompetencave në rezultate të të nxënit - grupimi i rezultateve të të nxënit në njësi do të kërkojë reflektim në lidhje me mënyrën e rigrupimit të rezultateve të të nxënit që janë të ngjashme sipas profileve. Për më tepër, është e rëndësishme të kihet parasysh se këto rezultate të të nxënit do të duhet të vlerësohen me një metodë të përshtatshme vlerësimi në të gjitha vendet pjesëmarrëse.

| NJËSITË E REZULTATEVE TË TË NXËNIT | NIVELI | ECVET | REZULTATET E TË NXËNIT |
|------------------------------------|--------|-------|--|
| NJËSIA 1 - TITULLI | KEK | ECVET | <p>Renditni këtu rezultatet e të nxënit që janë pjesë e njësisë përkatëse të rezultateve të të nxënit.</p> <p>Këto RN rrjedhin nga aktivitetet dhe kompetencat e renditura në standardin rajonal të profesionit por nuk janë domosdoshmërisht të strukturuar në të njëjtën mënyrë si aktivitetet përkatëse në standardin rajonal të profesionit.</p> <p>Njësia e rezultateve të të nxënit duhet të bëjë bashkë rezultatet e të nxënit që i përkasin të njëjtit profil dhe që mund të vlerësohen me një metodë të përshtatshme vlerësimi.</p> |
| NJËSIA 2 - TITULLI | KEK | ECVET | |

Vazhdoni të plotësoni tabelën me të gjitha njësitë e rezultateve të të nxënit që keni zhvilluar duke pasur parasysh vëllimin e përgjithshëm të standardit të kualifikimit si dhe nivelet e secilës njësi të rezultateve të të nxënit sipas përshkruesve të rezultateve të të nxënit në KEK. Përshkruesit e rezultateve të të nxënit përshkruajnë nivelin e njohurive, aftësive, përgjegjësinë përkatëse si dhe autonominë dhe duhet të shërbejnë si pikë referimi për hartimin e rezultateve të të nxënit të standardit të kualifikimit.

Jo të gjitha njësitë e rezultateve të të nxënit duhet të jenë në të njëjtin nivel me nivelin e standardit të kualifikimit- disa mund të vendosen në një nivel më të lartë dhe disa në një nivel më të ulët sesa niveli i kualifikimit. Sidoqoftë, është e rëndësishme që grupi i punës të arrijë një marrëveshje në lidhje me minimumin e njësive të rezultateve të të nxënit që duhet të korrespondojnë me nivelin e kualifikimit në mënyrë që të justifikojnë pozicionimin e kualifikimit në nivelin e duhur të kualifikimit.

Dhe mbi të gjitha, rezultatet e të nxënit duhet të rrjedhin nga standardet e profesionit në mënyrë që standardet e kualifikimit që do të zhvillohen të korrespondojnë me kërkesat e tregut të punës. Prandaj, njësitë e rezultateve të të nxënit të hartuara si elemente të një standardi kualifikimi duhet t'u përgjigjen detyrave kryesore, aktiviteteve kryesore dhe kompetencave përkatëse të paraqitura në standardet e profesionit dhe të miratohen nga grupi rajonal i punës mbi bazën e aktiviteteve kryesore.

Me shumë gjasa ndryshimet midis vendeve sa i takon përshkrimin të rezultateve të të nxënit të shprehura në njohuri, aftësi dhe qëndrime që i përkasin një standardi të një kualifikimi të caktuar janë të konsiderueshme. Sidoqoftë, kjo nuk duhet të përbëjë një pengesë për arritjen e dakordimit në lidhje me rezultatet e të nxënit që janë njohur dhe vlerësuar si rezultatet thelbësore të të nxënit në të gjitha vendet. Rezultatet thelbësore të të nxënit janë ato rezultatet që duhet të jenë pjesë e një standardi kualifikimi.

Mungesa e rezultateve të të nxënit në fjalë mund të na bëjë të mendojmë se perceptimi i ekspertëve në lidhje me një kualifikim me një titull të caktuar është krejtësisht i ndryshëm. Gjithashu, kjo mund të lidhet edhe me ndonjë problem të mundshëm sa i takon përkthimit ose anës gjuhësore por edhe thjesht një demonstrim i traditave të ndryshme kulturore. Prandaj identifikimi i rasteve të tilla dhe përdorimi i këtij lloj informacioni mund të jetë shumë i dobishëm.



